



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr 1391/ 5 prot.

Datë 22.07.2022

V E N D I M
Nr. 700/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Muça-2006*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me nr REF-28266-05-10-2022 me objekt: “*Blerje mjeti fadromë për sistemin e ujëitjes Bashkia Berat*”, me fond limit 9,817,500 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 10.06.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Start Co*” SHPK
Adresa: Bulevardi “*Gjergj Fishta*”, Kulla G&P, Kati 1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Berat.
Adresa: Rruga “*Antipatrea*”, Berat.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “*Muca-2006*” SHPK
Adresa: Lagjja “*Qender*”, Fshati Perondi, Berat.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin*

dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11-05-2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-28266-05-10-2022 me objekt: “Blerje mjete fadromë për sistemin e ujëitjes Bashkia Berat”, me fond limit 9,817,500 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 10.06.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.

II.2. Në datën 10.06.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3 Në datën 17.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Muca-2006” SHPK	9,500,000	lekë	kualifikuar
2. “Start Co” SHPK	9,640,000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 24.06.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe ka publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 85, me datë 27.Qershor.2022.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 29.06.2022, operatori ekonomik ankimues “*Start Co*” SHPK, ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “*Muca-2006*” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1391/2 prot., datë 29.06.2022 janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Start Co*” SHPK në lidhje me pretendimet për mospërmbushje të kriterëve nga ana e operatorit ekonomik “*Muca-2006*” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 3412/4 prot, datë 01.07.2022 protokolluar me tonën me nr. 1391/3 prot datë 04.07.2022, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Start Co*” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin refuzimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Start Co*” SHPK, mbi vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Muca-2006*” SHPK me arsyet: “*Nisur nga njohja e operatorit ekonomik dhe informacionet tona tregëtare ngremë përsëri dyshimet se në zbatim të kriterit operatori ekonomik “Muca-2006” shpk ka dështuar të verifikojë përmbushjen e plotë të tij pasi jemi të bindur se nuk ka paraqitur Akt Marrëveshje porosie/Kontratë porosie me prodhuesin e mjetit. Në përmbushje të kësaj pike OE-të ofertues duhet të paraqesin dokumentat e mjetit në rast se mjeti ndodhet në Shqipëri, është i zhdoganuar dhe duhet të jetë në pronësi të shoqërisë. Por sipas informacioneve tona ky OE nuk e ka në pronësi këtë mjet me këto specifikime teknike. Në rast të kundërt, i vetmi dokument që mund ta*

bëjë të kualifikueshëm ofertën dhe të përmbush kriterin e mësipërm është marrëveshja/kontrata porosisë midis kompanisë ofertuese dhe prodhuesit të mjetit apo distributorit të tij. Duke njohur kapacitetet dhe kompleksitetin e përgatitjes dhe lëshimit të këtij tip dokumenti në dyshojmë se OE “Muca-2006” shpk nuk e ka paraqitur/ ose e ka paraqitur në mënyrë jo të saktë dhe të plotë nga ana ligjore e cila e bën të dyshimt ofertën e tij dhe rrit rriskun e dështimit të realizimit të procedurës për AK që në fund të fundit kërkon një mjetë që është tejet i rëndësishëm për sistemin e ujëitjes”., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Për Mjetin operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë: a) Mjetin në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar

Per mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë detyrimisht të dhënat konkrete në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë.(sipas specifikimeve teknike te vendosura ne dst).

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimet teknike” të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektornike përcaktohet si më poshtë:

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Specifikimi i mjetit Fadrom:

Mjeti i ri me 0 ore pune.

Te dhenat teknike dhe opsionet e nevojshme te mjetit

Një (1) ngarkues shkarkues i ri me goma me :

Motor diesel STAGE V me Fuqi motorike 110HP/81kë

Me kambio manual 4she me lidhje te pauershift me teknologji te dyfisht singronizuese,

Shpejtesia maksimale e udhëtimit 41.8 km.

Kova e ngarkimit shume funksionale, Gjerësia 2.35m me nje kapacitet prej 1.0 km.

Krahe teleskopik me zgjatim dhe me kove gërmimi, Gjerësia 6100mm.

Kabina e siguria dhe certifikuar FOPS/ROPS me sistemin ngrohjes/ftohje. Paraqitje te brendshme te re, Timon tipit te ri.

Sistemi i avancuar i telekomunikacionit LIVELink.

Sistemi i vendndodhjes gjeografike satelitore ne kohe reale.

Transmeton tek perdorues te larget te gjitha informacionet vitale te funksionimit te makinerise.

Auto SRS.

Auto Stop. Fike motorri kur je ne gjendje minimo, pas nje periudhe te caktuar kohe, per te reduktuar konsumin e karburantit.

Auto 2ËD.Makineria mund te ndryshohet automatikisht ne 2ËD kur është e nevojshme për të zvogëluar konsumimin e gomave.

Manuali i funksionimit dhe mirëmbajtjes.

Pajisjet shitesë:

1. AC (kondicioner)

2. Thike nivalimi

3. GBS

4. SRS

NE MOMENTIN E MARRJES NE DOREZIM MJETI TE JETE I PAJISUR ME:

Leje qarkullimi, Certificate pronesia, Siguracion automjeti.

Garancia e mjetit 12 muaj (ku perfshihen nderimet e vajti sipas oreve te punes referuar katalogut).

Dorezimi i mjetit do te jete drenda 7 diteve.

III.1.3. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimet teknike” të modifikuar të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektornike përcaktohet si më poshtë:

I.1 Në lidhje me ndryshimet e dokumnetave standarte të tenderit specifikimet teknike të mjetetit tip fadrome për sistemin e ujitjes bëhen disa ndryshime si më poshtë vijon:

1. Motor diesel STAGE V me Fuqi motorike 110HP/81kë **ndryshohet dhe bëhet** Motor diesel me fuqi motorike 70 HP deri 110 HP dhe 80 kË deri 90 kË.
2. Me kambio manual 4she me lidhje te pauershift me teknologji te dyfisht singronizuese **ndryshohet dhe bëhet** Me kambio manual ose automatike.
3. Shpejtesia maksimale e udhëtimit 41.8 km **ndryshohet dhe bëhet** Shpejtesia maksimale e udhëtimit 40 - 50 km.

4. *Kova e ngarkimit shume funksionale, Gjerësia 2.35m me nje kapacitet prej 1.0 km **ndryshohet dhe bëhet** Kova e ngarkimit shume funksionale, me Gjerësia 2m deri 2.5m me një kapacitet deri ne 1 m3.*
5. *Krahe teleskopik me zgjatim dhe me kove gërmimi, Gjerësia 6100mm **ndryshohet dhe bëhet** Krahe teleskopik me zgjatim dhe me kove gërmimi, kova e gërmimit të jete me Gjerësi 6000mm deri 9000mm.*
6. *Sistemi i avancuar i telekomunikacionit LIVELink. Sistemi i vendndodhjes gjeografike satelitore ne kohe reale. Transmeton tek perdorues te larget te gjitha informacionet vitale te funksionimit te makinerise – keto kërkesa hiqen nga specifikimet teknike.*
7. *Pajisjet shitesë : GBS – kjo kërkesë hiqet.*
8. *Dorezimi i mjetit do te jete brenda 7 diteve **ndryshohet dhe bëhet** Dorezimi i mjetit do te jete brenda 30 diteve nga data e lidhjes se kontrates.*

I.1 Në lidhje me ndryshimet e dokumentave standarte të tenderit specifikimet teknike të mjetetit tip fadrome për sistemin e ujitjes bëhen disa ndryshime si më poshtë vijon:

1. *Motor diesel me fuqi motorike 70 HP deri 110 HP dhe 80 kË deri 90 kË ndryshohet dhe bëhet Motor diesel me fuqi motorike 70 HP deri 110 HP dhe 52 kË deri 82 kË.*
2. *Kërkesa për Auto Stop. Fike motorri kur je ne gjendje minimo, pas nje periudhe te caktuar kohe, per te reduktuar konsumin e karburantit – kjo kërkesë hiqet nga specifikimet teknike.*

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Muca-2006” SHPK në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Porosie Fadroma Nr. PP 05 TG SHQ-27.05.2022.
- Dokumenta Dorëzimi Fadroma Specifikme.
- Garancia CAT.
- Fotografi Fatdroma.

III.1.5. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.6. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në*

mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.7. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.8. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e

prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.1.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.1.10 . Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.11. KPP pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga ankimesi vëren se ka mospërputhje midis specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në dokumentin “Kushtet e Veçanta të Kontratës Nr. PP 05 TG SHQ-27.05.2022” të ankimesit. Konkretisht KPP konstaton se specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi të till si

krahu teleskopik me gjërësi 6000mm deri 9000mm, nuk përputhen me parametrat e pasqyruar në dokumentin “Kushtet e Veçanta të Kontratës Nr. PP 05 TG SHQ-27.05.2022” të paraqitur nga ana e ankimuesit. Gjithashtu në specifikimi teknik të pasqyruara në dokumentin “Kushtet e Veçanta të Kontratës Nr. PP 05 TG SHQ-27.05.2022” (700nm), të operatorit ekonomik “Muça-2006” SHPK, KPP vëren se nuk gjejnë pasqyrim të gjitha të dhënat e parashikuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 “Formulari Specifikimeve teknike”, si shpejtësia maksimale sipas përcaktimit të kërkuar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Sa më sipër Komisioni gjykon se operatorit ekonomik “Muça-2006” sh.p.k nuk plotëson specifikimet teknike në lidhje me produktet sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, duke mos dëshmuar se gëzon kapacitete për realizimin me sukses të kontratës.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi operatorit ekonomik ankumues “Start-Co” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankumues “Start-Co” SHPK mbi kualifikimin e shoqërisë “Muça-2006” SHPK., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi administrative, pasi referuar gjykimin më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Muça-2006” SHPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Start Co” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-28266-05-10-2022 me objekt: “Blerje mjeti fadromë për sistemin e ujëitjes Bashkia Berat”, me fond limit 9,817,500 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 10.06.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Muça-2006” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Start Co*” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Jonaid Myzyri në lidhje me vendimin e shumicës.

Si Kryetar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsyetimit të vendimit, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Start Co*” SHPK për procedurat e prokurimit me, Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Muça-2006*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me nr REF-28266-05-10-2022 me objekt: “*Blerje mjeti fadromë për sistemin e ujëitjes Bashkia Berat*”, me fond limit 9,817,500 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 10.06.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

I.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Start Co*” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “*Muça-2006*” SHPK me arsyetimin se “ *Nisur nga njohja e operatorit ekonomik dhe informacionet tona tregëtare ngremë përsëri dyshimet se në zbatim të kriterit operatori ekonomik “Muça-2006” shpk ka dështuar të verifikojë përmbushjen e plotë të tij pasi jemi të bindur se nuk ka paraqitur Akt Marrëveshje porosie/Kontratë porosie me prodhuesin e mjetit. Në përmbushje të kësaj pike OE-të ofertues duhet të paraqesin dokumentat e mjetit në rast se mjeti ndodhet në Shqipëri, është i zhdoganuar dhe duhet të jetë në pronësi të shoqërisë. Por sipas informacioneve tona ky OE nuk e ka në pronësi këtë mjet me këto specifikime teknike. Në rast të kundërt, i vetmi dokument që mund ta bëjë të kualifikueshëm ofertën dhe të përmbush kriterin e mësipërm është marrëveshja/kontrata porosisë midis kompanisë ofertuese dhe prodhuesit të mjetit apo distributorit të tij. Duke njohur kapacitetet dhe kompleksitetin e përgatitjes dhe lëshimit të këtij tip dokumenti në dyshojmë se OE “*Muca-2006*” shpk nuk e ka paraqitur/ ose e ka paraqitur në mënyrë jo të saktë dhe të plotë nga ana ligjore e cila e bën të dyshimt ofertën e tij dhe rrit rriskun e dështimit të realizimit të procedurës për AK që në fund të fundit kërkon një mjetë që është tejet i rëndësishëm për sistemin e ujëitjes”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

I.2. Në shtojcën 7/2 “*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*” pika 2.3 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Për Mjetin operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) *Mjetin në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar*

Per mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë detyrimisht të dhënat konkrete në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë.(sipas specifikimeve teknike te vendosura ne dst).

I.3. Gjithashtu, në shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimet teknike*” të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike autoriteti kontraktor ka parashikuar edhe specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi.

I.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “*Muca-2006*” SHPK në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Porosie Fadroma Nr. PP 05 TG SHQ-27.05.2022.
- Dokumenta Dorëzimi Fadroma Specifikme.
- Garancia CAT.
- Fotografi Fatdroma.

I.5. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

I.6. Së pari vlerësoj të sqarojë se Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve Komisioni mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, edhe parimin e kontradiktoritetit. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Së pari, mendoj se kërkimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me mospërbushjen e kriteve të vecanta të kualifikimit nga ana e operatorit ekonomik të kualifikuar nga autoriteti kontraktor nuk është i qartë, në rast se lidhet mbi mënyrën e disponueshmërisë së plotësisht të kërkesës (mjet në pronësi apo me kontratë porosie), kjo pasi Komisioni nuk mund të tejkalojë kufinj të shqyrtimit të ankesave, përcaktuar edhe në nenin 29 të VKPP 766/2021.

Megjithatë, një ndër elementët më të rëndësishëm në një procedim administrativ është ai i kontradiktoritetit, ku jo më kot ligjvënësi ka vendosur edhe ndër parimet e vecanta të veprimtarisë së Komisionit, sëbashku me atë të qëndrueshmërisë në vendimmarrje. Nga ana e shumicës së anëtarëve është vlerësuar se në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik nuk është dhënë informacion mbi dy elementë atë të shpejtësisë së mjetit dhe të dhëna mbi krahun e mjetit. **Njëkohësisht në ofertën teknike të distributorit të autorizuar, në të cilën janë pasqyruar edhe të dhënat teknike, saktësohet se “Për më tepër detaje teknike konsultohuni me specologun”.** Në kushtet e mësipërme, vlerësoj se, nga ana e Komisionit, para marrjes së vendimit përfundimtar duhet të ishte ndjekur veprimi procedural i të drejtës për tu dëgjuar i subjektit që preket nga vendimi, në përputhje me nenin 87 të Kodi të Procedurave Administrative, në drejtim të sqarimeve të cilat duhet ti kërkohen operatorit ekonomik të kualifikuar mbi mënyrën e përmbushjes së specifikimeve teknike.

Parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre.

Ndaj vlerësoj se në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Komisioni Prokurimit Publik duhet të kishte kryer të gjithë veprimet procedurale që ti jepej mundësia që operatorit ekonomik “Muça-2006” SHPK të paraqiste sqarimet për të provuar deklaratimet e tij.

Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar. Ky parim, ka gjetur zbatim në shumë vendimmarrje të qëndrueshme të Komisionit (shiko vendimin KPP 355/2022,525/2022 etj).

Nuk duhet të harrojmë qëllimin e ligjit të prokurimit publik, si në drejtim të sigurimit të trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë por edhe atë të mirëpërdorimit të fondeve publike dhe shpenzimeve proceduriale.

Kryetar
Jonaid Myzyri